



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

Pranuar me: Primljeno:	25.11.2022	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-463/02-63412		



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIM TË  
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463/02-17286 të datës 31.03.2022, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.463/01-17245 të datës 31.03.2022 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Konjuh, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit shpallë këtë:

**NJOFTIM**

**LIDHUR ME NJOFTIMIN PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË  
TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS Nr.1-463/02-45339 TË DATËS  
19.08.2022**

- I. **NJOFTOHEN** të gjithë aplikuesit për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale se **procesi i vlerësimit të ofertave për Njoftimin publik Nr. 1-463/02-45339 të datës 19.08.2022 ka përfunduar duke mos rekomanduar asnjë fitues** për shkak të mosarritjes së konsensusit me shumicë votash për ofertën më të favorshme.  
Andaj puna e Komisionit për këtë njoftim publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës Nr.1-463/02-45339 të datës 19.08.2022 përfundon si dhe anulohen të gjitha veprimet juridike të ndërmarra përkitazi me këtë Njoftim publik.
- II. Ky njoftim publik hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni Vlerësues.

## Arsyetim

Meqenëse Komisioni i zgjedhur më datën 31.03.2022 në përbërje prej 5 anëtarëve gjatë punës së vet duke analizuar dokumentacionin e ofertave dhe pas takimeve me biznese nuk gjen gjuhë të përbashkët për të ndërtuar prioritetet e vendosjes së bizneseve në parcelat përkatëse për secilin nga bizneset ofertuese, si pasojë e mendimeve të ndryshme dhe mosdakordimit për përzgjedhjen e ofertës fituese për pronat e shpallura duke konsideruar që shumica e bizneseve kanë aplikuar në një e më shumë prona duke mos përcaktuar në ofertë të shkruar prioritetin e pronave.

Kjo situatë ka sjellë konfuzion dhe mospajtueshmëri në Komision andaj duke marrë përbazë në tërësi këtë mbarëvajtje të procesit konsiderojmë që puna e Komisionit Vlerësues përfundon duke mos rekomanduar asnjë fitues në pronat e publikuara në mungesë të votave të mjaftueshme.

Komisioni Vlerësues në mënyrë unanime poashtu vlerëson që nga rrethanat e krijuara në këtë proces për shkak të mos arritjes së koncensusit nga anëtarët e komisionit propozon që punimet e këtij Komisioni të përfundojnë si në dispozitiv të këtij njoftimi.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Njoftimi.


Nr: 1-463/02-63412

Datë: 25.11.2022


1. Valon Pacolli, Kryesues i Komisionit

  
\_\_\_\_\_

2. Latif Ramadani, anëtar

  
\_\_\_\_\_

3. Armend Grajqevci, anëtar

  
\_\_\_\_\_

4. Lulzim Rustemi, anëtar

  
\_\_\_\_\_

5. Arbenita Gërxhaliu, anëtar

  
\_\_\_\_\_